

Nënkryetari i Qeverisë së Malit të Zi, Dritan Abazović, ka kumtuar se ligjet e miratuara për liritë e feve do të thotë siguri për pronën e Kishës ortodokse serbe në Mal të Zi



Ai, ka theksuar se nuk sheh ndonjë ngjashmëri të kësaj Qeverie me Qeverinë e PDS-së.

“Ky ligj nuk duhet të trajtojë çështjet pronësore dhe ky ka qenë gabim i ligjit të mëparshëm”, ka theksuar Abazović, duke shtuar se presidenti i Malit të Zi, Milo Gjukanović tani është i detyruar ta nënshkruaj sepse ky ligj miratohet për herë të dytë. Ai ka theksuar se edhe përkundër përshtypjes e cila krijohet , nuk është kryeministër i Malit të Zi. “Unë nuk jam kryeministër por kryeministër është Zdravko Krivokapić”.

Siç ka theksuar çështja e punësimeve partiake është duke u potencuar gjithnjë e më tepër. “Nuk shoh ndonjë ngjashmëri të kësaj Qeverie me Qeverinë e PDS. Në Qeverinë tonë gjenden 12 individë e që nuk janë partiak, duke shtuar se nuk mund të çmontohet regjimi i Gjukanoviçit brenda një dite. Ai, ka shtuar se do të ketë punësime të kuadrove politike, por në pajtim me ligjet dhe ka shtuar se përkrah

principin e ashpërsimit të kriterëve në konkurse për disa pozita të caktuara.

— rtcg.me